



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 7154 prot

Vlorë, më 14.04 2026

PROJEKT-VENDIM

‘PËR PËRCAKTIMIN E VENDQËNDRIMIT TË MJETEVE PËR TË CILAT JANË
VENDOSUR MASA ADMINISTRATIVE (GJOBA) PËR SHKELJE TË KODIT
RRUGOR”

Në mbështetje të Ligjit nr. nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar, Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Rregulloren dhe aktet e brendshme të Bashkisë, për administrimin e parkimeve dhe shërbimeve publike. Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) përkatëse, që lidhen me administrimin e trafikut rrugor dhe transportin, si dhe me relacionin nr. Datë i paraqitur nga grupi i punës.

VENDOSI:

1. Të përcaktojë pasurinë nr. 9/25, Zona Kadastrale 8604, me sipërfaqe 6292 m2 të përdoret si vendqëndrim i mjeteve për të cilat janë vendosur masa administrative për shkelje të Kodit Rrugor.
2. Për zbatimin e këtij projekt vendimi ngarkohet Policia Bashkiake, Drejtoria e Urbanistikës, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.



KRYETAR
Brunilda Mërsini

Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, www.vlora.gov.al; e-mail: info@vlora.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. 7154 prot

Vlorë, më 14.04 2026

RELACION

NË LIDHJE ME PËRCAKTIMIN E VENDQËNDRIMIT TË MJETEVE PËR TË
CILAT JANË VENDOSUR MASA ADMINISTRATIVE (GJOBA) PËR SHKELJE
TË KODIT RRUGOR

Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në zbatim të ligjeve:

- **Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”**, i ndryshuar, i cili përcakton kompetencat e bashkive për administrimin e hapësirave publike dhe ofrimin e shërbimeve vendore;
- **Ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”**, i ndryshuar, i cili parashikon rregullat e qarkullimit rrugor, masat administrative, si dhe bllokimin dhe largimin e mjeteve në rast shkeljesh;
- **Ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”**, i ndryshuar, që rregullon procedurat për vendosjen dhe ekzekutimin e masave administrative (gjobave);
- **Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”**, i ndryshuar, për përdorimin e tokës dhe përcaktimin e hapësirave për funksione publike;
- **Rregulloren dhe aktet e brendshme të Bashkisë**, për administrimin e parkimeve dhe shërbimeve publike.
- **Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) përkatëse**, që lidhen me administrimin e trafikut rrugor dhe transportin;

Ka përcaktuar si vendqëndrim të posaçëm për mjetet e bllokuara për shkak të shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor, një sipërfaqe toke të ndodhur në Zonen kadastrale 8604 Vlorë me nr.pasurie 9/25, Kodi Unik 8604 026097, me sipërfaqe 6292 m².

Kjo sipërfaqe përkon me pasurinë 9/25, Kodi unik 8604026097, dhe ndodhet në lagjen “24 Maji” Vlorë, përkon me hartën me indeks VL-GJ-7, në pronësi shtet. Kjo sipërfaqe ndodhet nw në veri të Hidrovorit të qytetit.

Ky vendqëndrim mjetesh ka për qëllim:

- Ruajtjen dhe administrimin e mjeteve të bllokuara;
- Zbatimin e masave administrative ndaj shkelësve;
- Lehtësimin e punës së strukturave përgjegjëse për kontrollin rrugor.

Vendqëndrimi i këtyre mjeteve do të administrohet nga Bashkia Vlorë, përgjegjëse për:

- Bllokimin e mjeteve.
- Largimin e mjeteve pas pagesave të gjobave.
- Vendorsjen e tarifave për vendqëndrimin nga Bashkia (lekw/natw).

Referuar kartelës dalë nga ASHK Vlorë në datën 11.03.2026, rezulton se pasuria 9/25, është e llojit Pyll me sipërfaqe totale 6292 m².

Nga shqyrtimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të Qytetit të Vlorës, të miratuar me Vendim Nr. 4 datë 17.05.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit Tiranë, Pasuria ndodhet në Njësinë Strukturore VL.IN.5 me të dhënat e mëposhtëme:

Bashkëlidhur fragment nga Plani I Përgjithshëm Vendor në njësinë strukturore VL.IN.5

Njësia Strukturore: VL.IN.5

Bashkia	Vlorë
Njësia	VL.IN.5
Sistemi	IN_Infrastrukturor
Kategori 1	IN.Infrastrukturë
Kategori 2	-
Kategori 3	-
Kategori 4	-
Lartësia në Kate	0
Lartësia në Metra	0
PDV	JO
Intesitet	K1=0
KSHT	K1=0%
KSHR	0%
KSHP	0%
Kufizime Ligjore	-
Sipërfaqe (ha)	7.87

Nenkategori 1 IN.7_Ujësjiellës-Kanalizime
Nenkategori 2 -
Nenkategori 3 -
Nenkategori 4
Parcela_Minimale K1=0
Përdorime të Lejuara -
Përdorime të Ndaluar -
Kushte të Tjera
Rregullore [More info](#)

1. Pra siç shihet pasuria 9/25 ndodhet në zonë infrastrukturore, që përkon me destinacionin e sëipërfaqes së truallit ku kemi planifikuar të miratohet vendqëndrimi I mjeteve.

2. Me VKM 684 datë 20.09.2020, Sektori I Pyjeve dhe Kullotave ka të miratuar inventarin kadastral të pyjeve dhe kullotave.

Lidhur me përcaktimin e llojit të pasurisë Pyll, në kartelën e pasurisë, i jemi drejtuar me shkresën nr.7130 datë 14.04.2026, Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, të cilët me kthim përgjigje me shkresën 7130/1 datë 14.04.2026, kanë konfirmuar faktin se pasuria 9/25, zk 8604 Vlorë, rezulton të jetë pasuri jashtë fondit pyjor kullosor. (Bashkëlidhur harta ardhur nga Sektori I Pyjeve dhe Kullotave me kufirin përkatës sipas VKM Nr.684, datë 20.09.2020).

3. Nga verifikimi faktik i terrenit nga grupi i punës ngritur me urdhër të brendshëm të Kryetarit të Bashkisë, për të verifikuar gjendjen fizike dhe llojin e pasurisë, rezulton që toka është në gjendje të lirë. Pra mbi këtë sipërfaqe nuk ka pyll, por është toke truall.

Konstatimet e mësipërme vërtetojnë faktin që prona është truall dhe kjo na jep të drejtë për të kërkuar në Këshill, miratimin përkatës për vendqëndrimin e mjeteve të cilat konstatohen të kenë kryer shkelje të kodit rrugor dhe rregullores së Bashkisë Vlorë.

Ju faleminderit!

DREJTOR

Bruna Bisholla

